



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT

*Mbi ecurinë e punës në IKP për vitin 2021*


Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca kryesore:

- a. Ushtron ankim ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim i cili shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b/5 i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, neni F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 63/1 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim, për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).


## I. STATISTIKË E PROCESIT

| Periudha      | Vendime të njoftuara nga KPK | Dispozitivi i vendimit të njoftuar |                     |                    | Rekomandime nga ONM | Vendime të shqyrtuara nga IKP | Ankime    | Mosankime  |
|---------------|------------------------------|------------------------------------|---------------------|--------------------|---------------------|-------------------------------|-----------|------------|
|               |                              | Konfirmim në detyrë                | Shkarkim nga detyra | Ndërprerje procesi |                     |                               |           |            |
| Viti 2018     | 77                           | 33                                 | 29                  | 15                 | 5                   | 77                            | 16        | 61         |
| Viti 2019     | 127                          | 55                                 | 44                  | 28                 | 5                   | 127                           | 13        | 114        |
| Viti 2020     | 103                          | 35                                 | 38                  | 30                 | 3                   | 103                           | 16        | 87         |
| Viti 2021     | 171                          | 62                                 | 68                  | 41                 | 8                   | 171                           | 14        | 157        |
| <b>Totali</b> | <b>478</b>                   | <b>185</b>                         | <b>179</b>          | <b>114</b>         | <b>21</b>           | <b>478</b>                    | <b>59</b> | <b>419</b> |



**Grafiku nr. 1 - Statistika përmblendhëse për vitet 2018-2021**


### Shkurt 2018 - 31 dhjetor 2021



**Grafiku nr. 2 - Ankime të Komisionerëve Publikë**


### Vendime të njoftuara nga KPK-ja

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2021, është njoftuar për 171 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, rreth 66% më shumë se viti 2020.




**Grafiku nr. 3 - Vendime të njoftuara nga KPK, 2018-2021**

### Vendime të njoftuara sipas dispozitivit (total 171 vendime) - viti 2021



**Grafiku nr. 4 - Vendime të njoftuara nga KPK - viti 2021, sipas dispozitivit**

### Vendime të njoftuara nga KPK - viti 2021




**Grafiku nr. 5 - Numri i vendimeve të njoftuara nga KPK sipas muajve, viti 2021**

### Rekomandime nga ONM-ja

Referuar nenit 65/2, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit B, pika c e aneksit të Kushtetutës, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur

ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).




**Grafiku nr. 6 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas viteve**

Në të gjitha rastet e rekomandimeve të ardhura në IKP, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ushtruar ankim kundër vendimeve të KPK-së.

**Shqyrtimi i vendimeve nga Komisionerët Publikë**


Gjatë vitit 2021, pas shqyrtimit të vendimeve të njoftuara nga KPK, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 14 vendime të KPK-së. Për 157 vendime është njoftuar mosankim. Shihni grafikun nr. 7.




**Grafiku nr. 7 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2021**



**Grafiku nr. 8 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, në vitet 2018-2021**




**Grafiku nr. 9 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas muajve, viti 2021**




**Grafiku nr. 10-Ankimet e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit në vitet 2018-2021**

### **Denoncimet nga publiku**

Administrimi i denoncimeve nga publiku ushtrohet në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë, në faqen zyrtare të IKP-së, “Formulari i Denoncimit nga Publiku” është vendosur në një menu të veçantë, të dukshme, si dhe në tabelën e Programit të Transparencës. Formularët, e plotësuar dhe të dërguar, administrohen nga Specialisti i Pritjes me popullin.



**Grafiku nr. 11 - Denoncimet nga publiku, në vite 2018-2022**



**Grafiku nr. 12 - Denoncimet nga publiku, viti 2021**

**Pjesëmarrja në seancat e gjyqimit të ankimit të IKP-së në KPA**


Referuar neneve 5/2, 63/1, 65/3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike.



Referuar neneve 5, pika 2, 63, pika 1, 65, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike.

Komisionerët Publikë kanë depozituar gjithsej **59** ankime në KPA (**16** në vitin 2018; **13** në vitin 2019; **16** në vitin 2020 dhe **14** gjatë vitit 2021).

Më poshtë paraqitet grafiku i seancave gjyqësore ndër vite, në të cilat kanë marrë pjesë Komisionerët Publikë.



**Grafiku nr. 13 - Numri i seancave në të cilat kanë marrë pjesë KP**

## **II. BUXHETI DHE MENAXHIMI I FONDEVE PUBLIKE**

Me ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, janë miratuar fondet buxhetore për Institucionin e Komisionerëve Publikë. Gjatë vitit 2021, zbatimi i buxhetit të institucionit është bazuar në parimin e ekonomikitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, aktet nënligjore në fushën e zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe drejtimit kryesorë të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2021 është në nivelin 97.8% ose 3.3% më e lartë se në vitin 2020.

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2021, në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, në total 74,350 mijë lekë, janë rishikuar gjatë vitit 2021 nëpërmjet rialokimeve brenda shpenzimeve korente, si dhe me akt normativ, duke pakësuar shpenzimet kapitale, dhe vlera totale e buxhetit arriti në 70,350 mijë lekë.

Në mijë lekë

| <b>Emërtimi</b>    | <b>Buxheti vjetor</b> | <b>Buxheti vjetor i rishikuar</b> | <b>Realizimi vjetor</b> | <b>Realizimi në %</b> |
|--------------------|-----------------------|-----------------------------------|-------------------------|-----------------------|
| Shpenzime korente  | 70,350                | 70,350                            | 68,776                  | 97,8 %                |
| Shpenzime kapitale | 4,000                 | -                                 | -                       | -                     |
| <b>TOTALI</b>      | <b>74,350</b>         | <b>70,350</b>                     | <b>68,776</b>           | <b>97,8 %</b>         |

Buxheti i miratuar për vitin 2021 ishte i mjaftueshëm në total për shpenzimet korente, por buxheti i miratuar në shpenzime personeli, në analogji dhe me vitet e kaluara, nuk i plotësonte nevojat në fushën e pagave për vitin 2021, siç është argumentuar në të gjitha komunikimet me Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në dokumentin e hartimit të Projektbuxhetit afatmesëm. Nga ana tjetër, buxheti i miratuar në shpenzime operative e tejkalohte kërkesën e institucionit për vitin 2021 dhe, gjatë vitit, me miratimin e MFE-së, u kryen rialokime, duke e pakësuar këtë buxhet dhe, ndërkohë, janë shtuar shpenzimet e personelit. Po kështu, shpenzimet kapitale e tejkalonin kërkesën e institucionit dhe, në dhjetor të vitit 2021, janë pakësuar në vlerë totale me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021, duke arritur në vlerën 0.

Për sa i përket shpenzimeve të kryera për furnizimin materialo-teknik të stafit të institucionit, administrimin e institucionit, krijimin e kushteve optimale, sa i përket masave mbrojtëse të shëndetit të punonjësve në kuadër të pandemisë COVID-19, ato janë kryer konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2021 dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjatë këtij viti janë kryer disa procedura prokurimi në zbatim të akteve të reja nënligjore dhe në përputhje me Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik, të miratuar dhe të ndryshuar sipas rastit me argumentimet përkatëse.

### **Projektbuxheti 2022-2024**

Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, si edhe akteve mbi hartimin e buxhetit të shtetit, DESHM është angazhuar në hartimin e kërkesave buxhetore për periudhën afatmesme 2022-2024. Institucioni i Komisionerëve Publikë i ka paraqitur kërkesat buxhetore pas miratimit në GMS dhe, brenda afateve ligjore, në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ka ndjekur të gjithë hapat ligjorë për paraqitjen dhe argumentimin në kohë të kërkesave buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Kërkesat buxhetore për këtë periudhë afatmesme janë përgatitur duke respektuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin për procedurat standarde të hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2022-2024 janë hartuar bazuar në eksperiencën e dy viteve të para të aktivitetit të institucionit, si dhe në detyrimet që rrjedhin prej akteve ligjore apo nënligjore në fuqi. Këto kërkesa përfshijnë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit, sipas strukturës organike të miratuar me Vendimin nr. 102/2018, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017”, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, si dhe shpenzime për mallra dhe shërbime të domosdoshme për aktivitetin e institucionit për vitin 2022, ndërsa për periudhën 2023-2024, nga institucioni nuk u paraqitën kërkesa buxhetore, referuar mandatit të Komisionerëve Publikë, i cili është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit të tyre, sipas përcaktimit në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Sipas artikujve, kërkesat buxhetore për vitin 2022 paraqiten në tabelën në vijim.

**Në mijë lekë**

| <b>Emërtimi</b>           | <b>Viti 2021</b> | <b>Viti 2022</b> |                           |
|---------------------------|------------------|------------------|---------------------------|
|                           |                  | <b>Kërkesa</b>   | <b>Buxheti i miratuar</b> |
| <b>TOTALI</b>             | <b>74,200</b>    | <b>73,528</b>    | <b>75,528</b>             |
| 600. Paga                 | 51,500           | 59,528           | 59,528                    |
| 601. Sigurime shoqërore   | 5,500            | 6,600            | 6,600                     |
| 602. Mallra dhe shërbime  | 13,200           | 7,400            | 7,400                     |
| 231. Aktive të trupëzuara | 4,000            | 0                | 2,000                     |